

UDHËTIMI I SHPRESËS MUND TË SHNDËRROHET NË NJË UDHËTIM SHKATËRRUES PËR JU DHE FAMILJEN TUAJ TË LUTEM, MENDOJU MIRË

Duke përdorur **rrugë të parregullta dhe të pasigurta** për të arritur në destinacionin tuaj, ju po e **ekspozoni** veten dhe familjen tuaj në rreziqe që kërcënojnë jetën. Përdorimi i rrugëve të parregullta ju bën që **ju dhe familja juaj** të jeni të rrezikuar nga **keqtrajtimet, dhuna, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe nga dënimet ligjore.**

Gjatë udhëtimit, ju dhe familja juaj mund të ballafaqoheni me situata në të cilat ju do të jeni më të rrezikuar nga dhuna. Pra, ju mund të jeni viktimë të dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike. Këto lloje të rreziqeve mund të manifestohen në forma të ndryshme:

Sulmi fizik: Kur bëni një udhëtim përmes rrugëve të pasigurta, ju mund të sulmoheni fizikisht, të plagoseni ose të vriteni nga individë apo anëtarët të grupeve të paligjshme, nëse nuk jeni në gjendje t'i paguani ose refuzoni t'i dorëzoni gjërat tuaja. Por, ju mund të sulmoheni edhe nga komunitetet lokale për shkak të ksenofobisë.





Sulmi/ngacmimi seksual: Gjatë udhëtimeve përmes rrugëve të parregullta të migrantëve / refugjatëve, veçanërisht gratë dhe të miturit e pashoqëruar mund të jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve siç janë: ngacmimi seksual, dhunimi por edhe veprimeve tjera që degradojnë integritetin seksual të personit. Ju lutemi bëni kujdes, sepse në rrethana të caktuara ju mund të përfundoni në skllavëri seksuale nga trafikantët e qenieve njerëzore, të cilët mund t'iu detyrojnë në prostitucion.

Braktisja/Mashtrimi: Gjatë udhëtimit, kontrabandistët mund t'iu lënë në pyll ose në lokacione të panjohura duke pretenduar se ju tashmë keni arritur në destinacionin e synuar.

Sulmi verbal/Fyerja: Shumë refugjatë / emigrantë mund të fyhen, poshtërohen ose kërcënohen nga ndonjë individë apo nga anëtarët e grupeve të paligjshme, individë apo grupe të caktuara nga komuniteti lokal ose madje edhe nga forcat e sigurisë përmes abuzimit verbal.





Grabitja e pasurisë/Puna e detyruar: Gjatë udhëtimit, paratë tuaja dhe sendet e tjera të vlefshme mund të grabiten nga grupe të organizuara të paligjshme siç janë kontrabandistët, trafikantët me qenie njerëzore ose individë apo grupe nga komunitetet lokale. Në pamundësi që t'i paguani grupet e paligjshme për shërbimet e tyre të kontrabandës, ata mund të shndërrohen në trafikant duke ju detyruar që të kryeni punë të pavullnetshme, siç është prostitucioni apo të ngjashme, në dobi të tyre.

Kushtet e rrezikshme për jetën: Varësisht nga mënyra se si vendosni të bëni udhëtimin dhe mjetet e transportit, të gjitha rrugët e paligjshme mbajnë rreziqet që kanosin jetën tuaj, siç janë:

Temperaturat ekstreme:

Në dimër, kur udhëtoni nëpër pyll, ju dhe familja juaj mund të vuani nga hipotermia, gjë që në shumicën e rasteve shkakton vdekjen e migrantëve gjatë rrugëtimit. Por, e njëjta vlen nëse udhëtoni me kamionë frigorifer, ose në rast se anija me të cilën po udhëtoni do të fundoset.





Uria dhe dehidratimi:

Gjatë udhëtimit, ju mund të humbisni në zona të panjohura dhe, në mungesë të ushqimit dhe ujit, mund të vdisni nga uria dhe etja. Por, e njëjta gjë vlen nëse udhëtoni me kamionë ose mjete të tjera transporti, kur kontrabandistët nuk ju lejojnë që të bartni me vete ushqim dhe ujë të mjaftueshëm.



Asfiksia: Gjatë udhëtimit, ju mund të futeni në një kamion ose mjete të tjera transporti që mund të mbingarkohen me refugjatë/migrantë të tjerë dhe për shkak të kohëzgjatjes së udhëtimit dhe mungesës së oksigjenit ju mund të bini viktimë e asfiksimit.





Sëmundjet dhe mungesa e higjienës: Gjatë udhëtimit, do të ndesheni me kushte të vështira higjienike të cila mund t'iu ekspozojnë ndaj infektimeve me sëmundje kërcënuese për jetën, siç janë: Covid-19, HIV/AIDS, Hepatiti, etj.



Minat dhe mjetet e pashpërthyera: Kur udhëtoni përmes pyjeve apo maleve, ju mund të kaloni nëpër zona të mbushura me mina tokësore duke rrezikuar që të shkelni mbi to.

Kafshët e egra: Gjatë kalimit të kufijve ndërshtetërorë përmes pyjeve apo maleve, ju mund të sulmoheni nga kafshë të egra.



PASOJAT JURIDIKE

Kur ndërmerrni udhëtime të pasigurta/të paligjshme, ju dhe familja juaj mund t'i nënshtroheni:

- Ndalimit apo arrestimit arbitrar të paligjshëm,
- Kthimit mbrapa apo mohimit të qasjes në territor,
- Në rrethana të caktuara ju mund të ndiqeni edhe penalisht për veprimet tuaja.

NDIHMË JURIDIKE

Programi për të drejtat civile - Kosovë (CRP/K)

☎ +383 (0) 38 243 610 / 611

✉ crp@crpkosovo.org

📍 **Rruga Lorenc Antoni Nr.15 / Qyteza Pejton / 10000 Prishtinë**

CRPK është organizatë joqeveritare lokale, partnerë të UNHCR



UNHCR
The UN Refugee Agency



CRP/K
CIVIL RIGHTS PROGRAM KOSOVO
PROGRAMI PËR TË DREJTAT CIVILE KOSOVO
PROGRAM GRADANDEN PRAVA KOSOVO